

KANUNI I MALEVE
Prof. Dr. Nikolla SPATHARI
Studiues, Akademia ‘Rrënjët Tona’

PËRMBLEDHJE

Kanuni nuk u gjet as në sëndukët e Lekë Dukagjinit, as në skrivaninë e Skenderbeut. Ai ndodhej prej shekujsh i ruajtur në kujtesën e popullit. Atje e gjeti Gjeçovi, siç e kishin gjetur edhe të tjerë para tij, por nuk e kishin trazuar. E kishin lënë të harrohej pakëngapak. Por nuk vdes asgjë që hyn në shpirtin e një populli. Kjo do të thotë se as Lekë Dukagjini, as Skenderbeu, as emrat e tjerë me të cilët janë emërtuar kanunet e krahinave, nuk e kanë filluar e aq më pak i kanë venë pikën në fund “Të Drejtës Dokësore Shqiptare”.

Fjalë kyçe: kanuni, kushtetute, peralle, mantel.

ABSTRACT

The Kanun was not found either in the chests of Lekë Dukagjini or in Skanderbeg's coffers. It was preserved for centuries in the memory of the people. Gjeçov found him there, as others before him had found him, but they had not disturbed him. They had let him be forgotten a little. But nothing dies that enters the soul of a people. This means that neither Lekë Dukagjini, nor Skenderbeu, nor the other names with which the canons of the provinces were named, have started it, much less put an end to "Albanian Land Law".

Key word: canon, constitution, story, cloak.

HYRJE

Duke e lidhur Kanunin me emra të veçantë, madje edhe me dyer të mëdha krahinash, kulturës tonë të lashtë i është bërë dhe vazhdon t’i bëhet shërbimi më i keq i mundshëm. Më e pakta që mund të thuhet: i hiqet lashtësia. Por duke i hequr Kanunit lashtësinë, i heqim kombit krenarinë e disponimit të një monumenti shumë të vjetër të së drejtës dokesore. Nuk besoj të ketë ndonjë popull tjetër në botë, që për interesa fare të vogla, siç është çeshtja për t’i dhënë atributë, që nuk i ka një njeriu, një dere apo edhe një krahinë, e hedh lashtësinë e vet si një mantel të grisur e pa vlerë. Që në kohrat, kur besohej se njerëzit dilnin nga dhëu i pa forcuar ende, grupet shoqërore e lakmonin shumë prejardhjen e lashtë dhe autoktoninë, sepse të jesh autokton, në kuptimin etimologjik, do të thotë të kesh dalur nga toka, nga ajo tokë ku je prej shekujsh, siç dalin edhe pemët. Për lashtësinë e normave tona kanunore, flet edhe fakti se në *Kanunin tonë* ka plot ligje që zbatoheshin edhe në *Romën e Lashtë*. Madje ka mendime se ato janë mbartur nga e drejta e Ilirëve të vjetër, nepërmjet të përandorëve romakë me origjinë ilire që, siç dëshmon historia, nuk janë pak. Por, edhe këto mendime janë të njëanëshme, sepse në mes të dy popujve, që i ka lidhur gjatë historia, janë të pashmangshëm si roli dhënës ashtu edhe roli marrës. Askush nuk mund ta mohojë se edhe Lekë Dukagjini, edhe Skenderbeu ishin njerëz të shquar si në fushën ushtarake ashtu edhe në fushën e *ligjvënjes kanunore*. Por burra të tillë ligjvënës, populli iliro-shqiptar, ka pasur para tyre e pas tyre.

KANUNI I MALEVE

E Drejta Dokësore Shqiptare, që ka mbetur e koncentruar në *Kanunin e Maleve*, domosdo nuk ka qenë statike. Veçanërisht, në kohën e qëndresës së madhe shqiptare ndaj Përandorisë Osmane, të udhëhequr nga Skendërbeu dhe Lidhja e Princave. Domosdo është parë nevoja e ndryshimeve dhe e plotësimeve të reja në këtë *Kanun* të lashtë. Dhe pa dyshim në këto ndryshime e plotësime, që i diktonte koha, Skendërbeu dhe Lekë Dukagjini kanë pasur rrol parësor. Por kjo nuk do të thotë se janë ata autorët e *kanuneve*. Në *Kanunin e Skanderbegut*, të mbledhur dhe të kodifikuar nga Dom Frano Illia, thuhet: “*Ligje të reja kanunore ka të drejtë e fuqi me ba vetem populli: Pari e vogli*”¹). Pra edhe në qoftë se Lekë Dukagjini vërtetë i ka udhëhequr të gjitha kuvendet dhe pleqësitë, ligjet e bëra nuk janë vepër e tij, po e gjithë popullit, pari e vegjëli. Kjo është e qartë. Ajo që mbetet akoma e errtë është çështja e emrit: Përse u quajt *Kanuni i Lekë Dukagjinit*? Mbase ka të drejtë Fishta që shtron tezën “*Kanuni i Lekëve dhe i Dukagjinëve*“. Këta dy emra, që u bënë një në emërtimin e *Kanunit tonë*, duke qenë njëkohësisht edhe emri e mbiemri i një princi të fuqishëm e ligjvenës, ndoshta evokojnë edhe tek populli ynë atë praktikë botërore, kur ligjet jetonin në kujtesën e popujve me emrat e mbretërve dhe princave. Kështu ka ndodhur pothuajse gjithmonë, që nga *ligjet e Hamurabit* në Babiloni, të *Manu-së* në Indi, të *Drakonit* në Greqi, të *Likurgut* në Spartë e deri te *ligjet e Stefan Dushanit*, që u zbatuan edhe në trojet tona në kohën e sundimit të tij.

Pa pretenduar se *E Drejt Dokesore Shqiptare* nuk është prekur në kohën kur kanë jetuar Skenderbeu dhe Lekë Dukagjini, unë vë re se brenda vetë *Kanunit të Maleve* gjenden fakte të pakundërshtueshme se ai nuk mund të jetë vepër e një njeriu, sado i fuqishëm të ketë qenë. Neni 20 i *Kanunuit të Skanderbegut*, që e cituam më lart, e thotë në mënyrë taksative. Pak a shumë të njëjtën gjë pohon edhe *Kanuni i mbledhur nga Gjeçovi* në nenin 992. Pasi ka folur në nenin pararendës për pleqtë e Kanunit, në këtë nen vazhdon mendimin: “*Pa këta nuk mund të bahet ndo'i kanun i ri*”². Pra një njeri i vetëm, në rradhë të parë, nuk ka tagër nga *E Drejta Dokesore Shqiptare* të bejë ligje kanunore, e aq më pak terësinë e ligjeve gojëdhane të *Kanunit e të Maleve*. Por, edhe vetë logjika nuk e pranon. As në kohën e sotme që ka juristë të famshëm, profesorë të të drejtës ndërkombëtare, kushtetutat e vendeve nuk i bën një njeri, sado i padiskutueshëm të jetë autoriteti i tij shkencor.

Nëqoftëse *kanunet* i lidhim me emra të veçantë dhe konkretisht me emrat famëmëdhenj të Skënderbeut e të Lekë Dukagjinit, atëherë dalin edhe mjaft probleme historike. A nuk ju duket se kjo gjë do të trondiste në themel *Besëlidhjen e Lezhës* të vitit 1444. Po qe se Lekë Dukagjini do të ulej e do të bënte një *kanun*, dhe nga ana tjetër edhe Skënderbeu, pa ia varur fare Lekës, do të bënte një *kanun* tjetër, si do t’mund të drejtohej lufta e suksesshme kundër Perandorisë së fuqishme Osmane!? Sigurisht një luftë e tillë nuk do t’mund të ishte kurrësi një luftë fitimtare po qe se, në rregullimin ligjor popullor, njeri princ i besëlidhur i binte gozhdës e tjetri patkoit. Kanuni i Maleve është “Kushtetuta“ më jetëgjatë, me të cilën është rregulluar vetëqeverisja republikane e Maleve tona në shekuj. Është kjo një “kushtetutë” që pleqtë e kanunit, nëpër malësi, e dinë përmendësh, ndaj kurrë nuk i besuan përrallat me “themelet e kanunit në një kullë“, apo se vetë kanuni ka dalë nga skrivania e ndonjë princi.

¹) Dom Frano Illia – *Kanuni i Skanderbegut*, Editrice La Rosa 1993, faqe 16.

²) At Shtjefni K. Gjeçov O.F.M. – *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, 1933, & 1993, fq. 94.

PËRFUNDIME

Kanuni i Maleve është “kushtetuta“ më jetëgjatë, me të cilën është rregulluar vetëqeverisja republikane e Maleve tona në shekuj.

Është kjo një “kushtetutë” që pleqtë e kanunit, nëpër malësi, e dinë përmendësh, ndaj kurrë nuk i besuan përrallat me “themelet e kanunit në një kullë“, apo se vetë kanuni ka dalë nga skrivania e ndonjë princi.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Dom Frano Illia – Kanuni i Skanderbegut, Editrice La Rosa 1993, faqe 16.
2. At Shtjefni K. Gjeçov O.F.M. – Kanuni i Lekë Dukagjinit ,1933, & 993,fq. 94.